

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS - OPSTINA PRISTINA
19-10-2023
14-024/01-208373/23
Nr./Br.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtorija e Administratës
Direktorijati za Administraciju
Yonetim Mûdûrlûgü
2 HYRËSE-ULAZ-GİRİS
08-030 Nr. 150888 Dt. 24/10/23



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref. Nr. 5310 / 2023 - 09
Data / Datum / Date 17. 10. 2023
Nënshkrimi / Potpis / Signature
PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHITIMËS / OPSTINA SHITIMËJE
Nr. i Prot./Br. Prot. 02/211
Nr. i Faqeve / Strana 8
Data / Datum / Date 24. 10. 2023
SHITIMË / SHITIMLJE

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA KLLKOT / KOMUNA E KLLKOTIT
1343/1 18.10.23
MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT
KLLKOT / KLLKOTIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Datum 03/11/2023
Nr. Orgv. / Org. jed. 01 Nr. Prot. / Br. Prot. 397/25 Nr. Faqeve. / Br. Strana. 8
Ferizaj - Uroševac

NDËRMJET

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
18/10/2023
02 035 02 / 127

Republika e Kosovës - Republika Kosova
MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT,
Drejtorija për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURİYETİ
KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GJILANE - GILAN BELEDİYESİ
02-016-110492
18.10.2023
Dala/Datum/Date GJILAN - GJILANE - GILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUÇITR
Nr. / Br. 51327/25
-8-
Data / Datum / Date 23. 10. 2023
VUSHTRRI - VUÇITR

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS - OPSTINA MITROVICA
DHE
12-050/01-0078175/23
23-10-2023
Mitrovicë - Mitrovica

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHERBIMTE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 3481
Nr. i faq. / Br. str. 8 Data / Datum / Date 18/10 2023
KAMENICE/A

KOMUNËS SË DRENASIT

KOMUNËS SË PEJËS

KOMUNËS SË FERIZAJT

KOMUNËS SË PRISHTINËS

KOMUNËS SË GJAKOVËS

KOMUNËS SË PRIZRENIT

KOMUNËS SË GJILANIT

KOMUNËS SË RAHOVECIT

KOMUNËS SË KAMENICËS

KOMUNËS SË SUHAREKËS

KOMUNËS SË KLLKOTIT

KOMUNËS SË SHITIMËS

KOMUNËS SË MALISHEVËS

KOMUNËS SË VITISË

KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

KOMUNËS SË VUSHTRRISË

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVECI / OPSTINA RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIDENKA OPŠTINE / MUNICIPALITY ARCHIVE
Njësia Nr./Br./No. 3276
Nr./Br./No. 3276
Data / Datum / Date 30/10/2023
RAHOVEC / ORAHOVEC

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
KRYETARI I KOMUNËS / OPŠTINA PEÇ / OPĆINA PEĆ
ARHIVA I ARHIVA ARCHIVE
01-400/01-106200
Nr. / Br. / No. Nr. i faq. / Br. str. / No. dg
FEDERATA E FUTBOLLIT
E KOSOVËS
Nr. Ref. 145214
Data 30.10.2023
Nënshkrimi. (Mw)
Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRE NË DORËZIM PRILMËNJË RECEIVED
Njesia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit 10
Numrit / Broj / Number 10.016
Shtojca / Prilog / Appendix
Vlera / Vrednost / Value
30/10/2023
68114 SUHAREK PRISHTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
GLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 30/10/2023
Nj. Org. / Num. / Shtojca / Vlera
01-400/01-53725

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Drenasit, Komuna e Ferizajit, Komuna e Gjakovës, Komuna e Gjilanit, Komuna e Kamenicës, Komuna e Klokotit, Komuna e Malishevës, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Komuna e Pejës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit, Komuna e Rahovecit, Komuna e Suharekës, Komuna e Shtimes, Komuna e Vitisë, Komuna e Vushtrrisë dhe Federata e Futbollit e Kosovës, përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit zotohen të bashkërendojnë angazhimin profesional dhe investimet kapitale sipas kompetencave përkatëse institucionale dhe obligimeve të përcaktuara me këtë Memorandum në zbatimin e plotë të Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit.

Përmes Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit sigurohen kapacitetet adekuate fizike në Republikën e Kosovës për zhvillimin e ngjarjeve garuese ndërkombëtare dhe vendore, trajnimin e ekipeve lokale dhe edukimin e talentëve të rinj në sportin e futbollit.

Neni 2

Autoritetet

2.1. Qëllimi i Bashkëpunimit do të përmbushet nga:

- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejshëm MKRS);
- Komuna e Drenasit;
- Komuna e Ferizajit;
- Komuna e Gjakovës;
- Komuna e Gjilanit;
- Komuna e Kamenicës;
- Komuna e Klokotit;
- Komuna e Malishevës;
- Komuna e Mitrovicës së Jugut;
- Komuna e Pejës;
- Komuna e Prishtinës;
- Komuna e Prizrenit;
- Komuna e Rahovecit;
- Komuna e Suharekës;
- Komuna e Shtimes;
- Komuna e Vitisë;
- Komuna e Vushtrrisë;
- Federata e Futbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm FFK).

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

Neni 3

Caqet

Palët pajtohen që në bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve të punojnë ngushtë në:

3.1. Krijimin e mekanizmave të përbashkët koordinues, duke siguruar koordinim të plotë të palëve në planifikimin dhe zbatimin e Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit, sipas përgjegjësiwe institucionale dhe obligimeve të përcaktuara me nenin 4, 5 dhe 6 të këtij Memorandumi;

3.2. Përmeshja e nevojave themelore të komunitetit të sportit të futbollit për zhvillimin e aktiviteteve përgatitore dhe garuese, ndërkombëtare dhe vendore, përmes konsolidimit të infrastrukturës fizike në 16 komuna të Republikës së Kosovës;

3.3. Zhvillimi dhe aplikimi i mekanizmave adekuatë për menaxhim të qëndrueshëm të infrastrukturës fizike të futbollit në tërë Republikën e Kosovës.

Neni 4 **Obligimet e MKRS**

4.1. MKRS në parim është e obliguar:

- 4.1.1. Të zhvillojë projektin ideor dhe zbatues për stadiumet e kategorizuara sipas standardeve të UEFA-së (kategoritë 2, 3 dhe 4) të përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit;
- 4.1.2. Të sigurojë mjetet financiare për zbatimin e projekteve si në pikën 4.1.1. përmes grantit qeveritar apo burimeve të tjera të financimit;
- 4.1.3. Të menaxhojë realizimin e projekteve kapitale si në pikën 4.1.1. përfshirë kompletimin e dokumentacionit teknik të projektit, lejet dhe pëlqimet përkatëse, kontraktimi i operatorëve ekonomikë për realizimin e projektit, zhvillimi i planeve të detajuara dinamike, mbikëqyrja e realizimit të punëve ndërtimore dhe pranimin teknik;
- 4.1.4. T'u ofrojë mbështetje profesionale Komunave në hartim të projekteve ideore dhe zbatuese të infrastrukturës lokale të futbollit, mbikëqyrje të ekzekutimit të punëve ndërtimore dhe pranim teknik për projekte të përzgjedhura;
- 4.1.5. Të ofrojë mbështetje në përcaktimin e lokacionit dhe procesin e shpronësimit (sipas nevojës) të parcelave ndërtimore për projektet si në pikën 4.1.1.;
- 4.1.6. Të ofrojë mbështetje në zhvillimin e planeve të menaxhimit për infrastrukturën fizike të futbollit;
- 4.1.7. Të bashkëfinancojë realizimin e projekteve të infrastrukturës lokale për projekte të përzgjedhura;
- 4.1.8. Të ofrojnë mbështetje në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ndërtuar fizike sipas planeve të miratuara të menaxhimit.

4.2. Roli dhe përgjegjësitë e MKRS-së përkitazi me projektetet e përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit janë definuar në Aneksin 1 në verzionin aktual dhe në të gjitha verzionet e ardhshme në bazë të plotësimeve nga grupi koordinues;

4.3. MKRS obligohet të bëjë planifikimin buxhetor për projektet e përcaktuara në Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit brenda kufijve buxhetorë të përcaktuar me Qarkoren përkatëse Buxhetore, sipas Aneksit 2.

Neni 5

Obligimet e Komunave

5.1. Komunat e përfshira në këtë memorandum në parim janë të obliguara:

5.1.1. Të sigurojnë lokacionin për projektet e Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit, konform standardeve dhe kërkesave përkatëse për zbatimin e tyre, dhe dispozitave ligjore që rregullojnë dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;

5.1.2. Të ofrojnë mbështetje në zhvillimin e dokumentacionit teknik, sipas nevojës, në procese të shpronësimit të parcelave ndërtimore për qëllim të zbatimit të projekteve si në pikën 5.1.1.;

5.1.3. Të ofrojnë rrjetin e infrastrukturës teknike të kapacitetit adekuat për nevojat e stadioneve dhe funksioneve mbështetëse deri në kufirin e parcelës ndërtimore të projekteve si në pikën 5.1.1., duke përfshirë rrjetin furnizues të ujës-jellësit dhe ujërave të zeza, energjisë elektrike, ngrohjes qendrore, rrjetit rrugor dhe infrastrukturës tjetër sipas kërkesës së parashtruar nga institucioni bartës i hartimit dhe/apo zbatimit të projektit;

5.1.4. Të ofrojnë mbështetje në mbikëqyrjen e projekteve të zhvilluara nga MKRS në komunat përkatëse;

5.1.5. Të zhvillojnë projektin ideor dhe zbatues për stadiumet lokale dhe fushat ndihmëse të futbollit të përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar të Infrastrukturës së Futbollit;

5.1.6. Të sigurojnë mjetet financiare për zbatimin e projekteve si në pikat 5.1.3. dhe 5.1.5. përmes grantit qeveritar apo burimeve të tjera të financimit;

5.1.7. Të menaxhojnë realizimin e projekteve kapitale si në pikat 5.1.3. dhe 5.1.5. përfshirë kompletimin e dokumentacionit teknik të projektit, lejet dhe pëlqimet përkatëse, kontraktimi i operatorëve ekonomikë për realizimin e punëve ndërtimore, zhvillimi i planeve të detajuara dinamike, mbikëqyrja e realizimit të punëve ndërtimore dhe pranimin teknik;

5.1.8. Të ofrojnë mbështetje në zhvillimin e planeve të menaxhimit për infrastrukturën fizike të futbollit;

5.1.9. Të ofrojnë mbështetje në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ndërtuar fizike sipas planeve të miratuara të menaxhimit.

5.2. Roli dhe përgjegjësitë e Komunave të përfshira në këtë Memorandum Bashkëpunimi përkitazi me projektet e përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit janë definuar në Aneksin 1 në verzionin aktual dhe në të gjitha verzionet e ardhshme në bazë të plotësimeve nga grupi koordinues;

5.3. Komunat e përfshira në këtë Memorandum Bashkëpunimi obligohen të bëjnë planifikimin buxhetor për projektet e përcaktuara në Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit brenda kufijve buxhetorë të përcaktuar me Qarkoren përkatëse Buxhetore, sipas Aneksit 2.

Neni 6

Obligimet e FFK

6.1. FFK në parim është e obliguar:

6.1.1. Të ofrojë ekspertizë profesionale në hartim të detyrave projektuese, projekteve

ideore dhe zbatuese për projektet e përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit;

6.1.2. Të ofrojë ekspertizë profesionale në vlerësim të projekteve ideore dhe zbatuese të hartuara nga MKRS dhe Komunitet e përfshira në këtë Memorandum Bashkëpunimi;

6.1.3. Të ofrojë mbështetje në aprovim dhe licensim të stadioneve të kategorizuara sipas standardeve të UEFA-së, dhe në të gjitha rastet ku aplikohet;

6.1.4. Të ofrojë mbështetje në mbikëqyrje dhe inspektim të zbatimit të projekteve të hartuara nga MKRS dhe Komunitet e përfshira në këtë Memorandum Bashkëpunimi;

6.1.5. Të zhvillojë dhe ekzekutojë planet për menaxhim të aseteve për të gjitha projektet e përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit;

6.1.6. Të ofrojë mbështetje në komunikimin në mes të palëve të përfshira në këtë Memorandum Bashkëpunimi dhe organizatave ndërkombëtare të futbollit, UEFA dhe FIFA;

6.1.7. Të ofrojë mbështetje në mobilizim të kapitalit financiar për investime në Republikën e Kosovës dhe të bashkëfinancojë realizimin e Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit, sipas Aneksit 2.

6.2. Roli dhe përgjegjësitë e FFK-së përkitazi me projektet e përcaktuara me Planin Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit janë definuar në Aneksin 1 në verzionin aktual dhe në të gjitha verzionet e ardhshme në bazë të plotësimeve nga grupi koordinues;

Neni 7

Mekanizmat koordinues

7.1. Për zbatimin e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit palët pajtohen të themelojnë grupin koordinues për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit;

7.2. Grupi koordinues do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, gjegjësisht 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Sportit/MKRS, 1 (një) përfaqësues nga Zyra e Prokurimit/MKRS, 3 (tre) përfaqësues nga FFK, përkatësisht profile profesionale në fushën e arkitekturës, ndërtimtarisë, juridikut dhe/apo prokurimit publik dhe 2 (dy) përfaqësues me rotacion nga Kolegjiumi për Kulturë, Rini dhe Sport/Asociacioni i Komunave të Kosovës nga komunitet partnerë në këtë Memorandum Bashkëpunimi;

7.3. Takimet e grupit koordinues organizohen sipas nevojës, por së paku 1 (një) herë në muaj;

7.4. Grupi koordinues përcakton kryesuesin e grupit koordinues me konsensus, i cili është i obliguar të thërrasë takimet, të ofrojë pikat e rendit të ditës dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit koordinues të hartojë raportet e takimeve punuese për strukturat udhëheqëse të palëve.

7.5. Grupi koordinues ka kuorum dhe mund të marrë vendim nëse në të marrin pjesë shumica e anëtarëve. Secila palë mund të ndryshojë anëtarin e Grupit Koordinues me njëjtim paraprak prej 15 ditësh.

7.6. Grupi koordinues është përgjegjës:

7.6.1. Të hartojë planin vjetor të punës, bazuar në planet e detajuara dinamike për realizimin e projekteve në kuadër të Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit;

7.6.2. Të monitorojë realizimin e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, përkatësisht obligimeve përkatëse të palëve partnere sipas nenit 4, 5 dhe 6;

7.6.3. Të monitorojë realizimin e planeve të detajuara dinamike për projektet e përveçme, t'i identifikojë sfidat dhe të ofrojë rekomandime për nivelet përkatëse vendimmarrëse për masat që duhet të ndërmerren;

7.6.4. Të mobilizojë kapitalin e nevojshëm profesional për adresimin e sfidave që paraqiten në realizimin e planeve të detajuara dinamike.

7.6.5. Pas analizimit, hulumtimit dhe të gjeturave në terren, mund të ndryshojë ofroj rekomandime për plotësim-ndryshimin e Planit Pesë-Vjeçar për Infrastrukturën e Futbollit-Aneksin 1 dhe Aneksin 2 të këtij memorandumi. Për çdo përditësim nevojitet pëlqimi i MKRS-së, FFK-së dhe komunës përkatëse ku gjendet projekti infrastrukturor.

7.7. Grupi koordinues vepron në kuadër të FFK, themelohet dhe mbështetet financiarisht nga MKRS, në përputhje me legjislacionin përkatës të sportit dhe menaxhimit të financave publike. Grupi koordinues sipas nevojës mundet gjithashtu të mbështetet edhe nga FFK-ja dhe subjektet tjera.

7.8. Grupi koordinues harton raporte 3 (tre) mujore për progresin e zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit për strukturat udhëheqëse të palëve.

Neni 8 Zbatimi

8.1. MKRS në bashkëpunim me FFK-në dhe Komunitat përkatëse, përcjellin zbatimin e Memorandumi të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e Memorandumi.

8.2. Palët në vazhdim obligohen të zbatojnë Ligjet në fuqi që rregullojnë kompetencat institucionale, menaxhimin e investimeve kapitale, menaxhimin e financave publike dhe prokurimin publik.

Neni 9 Kohëzgjatja e Memorandumi

Afati i realizimit të Memorandumi të Bashkëpunimit është deri në fund të vitit 2028, me mundësi vazhdimi.

Neni 10 Amandamenti

10.1. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshohet apo plotësohet sipas rekomandimeve të grupit koordinues apo me kërkesë të MKRS apo FFK, dhe pëlqim prej MKRS dhe FFK.

10.2. Në bazë të rekomandimeve të grupit koordinues dhe me pëlqim prej MKRS-së dhe FFK-së, neni 2 i këtij memorandumi mund të plotësohet me komuna të tjera me anë të një aneks memorandumi me komunën përkatëse, duke respektuar të gjitha nenet tjera të këtij memorandumi.

10.3. Aneksi 1 i këtij Memorandumi - Plani Infrastrukturor mund të të ndryshohet, plotësohet apo përditësohet nga Grupi Punues pas analizimit, hulumtimit dhe të gjeturave në terren. Për çdo përditësim të Aneksit 1 dhe Aneksit 2 nevojitet pëlqimi i MKRS-së, FFK-së dhe komunës përkatëse ku gjendet projekti infrastrukturor.

Neni 11

Mundësia e ndërprerjes së Memorandumit të Bashkëpunimit dhe rrethanat e paparashikuara

Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve. Nëse implementimi i këtij memorandumi nuk mund të realizohet për shkak të forcës madhore dhe rrethanave tjera të paparashikuara, palët do të vendosin bashkërisht për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 12

Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 13

Kopjet dhe gjuha e memorandumit

Ky Memorandum është përpiluar në tetëmbëdhjetë (18) ekzemplarë origjinalë identikë në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Secila palë do të ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar nga të dy gjuhët.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të gjitha palët dhe është i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2028.

Hajrulla ÇEKU
Ministër
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Agim ADEMI
Kryetar
Federata e Futbollit e Kosovës



Ramiz LLADROVCI
Kryetar, Komuna e Drenasit

Agim ALIU
Kryetar, Komuna e Ferizajt

Arjan GJINI
Kryetar, Komuna e Gjakovës

Alban HYSENI
Kryetar, Komuna e Gjilanit

Kadri RAHIMAJ
Kryetar, Komuna e Kamenicës

Vladan BOGDANOVIĆ
Kryetar, Komuna e Kllokotit

Ekrem KASTRATI
Kryetar, Komuna e Malishevës

Bedri HAMZA
Kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut

Gazmend MUHAXHERI
Kryetar, Komuna e Pejës

Bhaqir TOTAJ
Kryetar, Komuna e Prizrenit

Smajl LATIFI
Kryetar, Komuna e Rahovecit

Përparim RAMA
Kryetar, Komuna e Prishtinës

Balt MUHARREMAJ
Kryetar, Komuna e Suharekës

Qemajl ALIU
Kryetar, Komuna e Shtimes

Sokol HALITI
Kryetar, Komuna e Vitisë

Ferit IDRIZI
Kryetar, Komuna e Vushtrrisë